

Njoftim mbi Përdorimin e të Dhënave të Hapura

Në mbështetje të Ligjit nr. 33, datë 31.03.2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, si dhe Udhëzimit të përbashkët nr. 2, datë 06.02.2025, sqarojmë se, edhe pse aktualisht të dhënat e publikuara nuk shoqërohen me një licencë të posaçme për ripërdorim, çdo person fizik apo juridik që i përdor këto të dhëna ka detyrimin ligjor dhe etik të citojë qartë burimin e informacionit.

Citim i saktë i burimit është një praktikë që garanton transparencë, ruan integritetin e të dhënave dhe vlerëson kontributin e Institucionit si krijues dhe shpërndarës i informacionit publik. Mospërbushja e këtij detyrimi përbën shkelje të parimeve etike dhe të standardeve të përdorimit të informacionit publik.

Për çdo rast përdorimi, riprodhimi apo përpunimi të të dhënave të publikuara nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër, duhet të përdoret formulimi i mëposhtëm:

“Burimi: Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër – të dhëna të hapura, [data e publikimit ose linku]”.